

ALBAVIA sh.p.k
Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të pavarur
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 24

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe ortakëve të Shoqërisë Albavia sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Albavia sh.p.k (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

29 mars 2017


Luan Kamberi
Auditues Ligjor



Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	73,668,812	90,127,141
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	386,255,817	616,971,148
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	442,709,407	575,000,975
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	15,699,189	15,582,724
Inventarë	8	21,350,358	31,559,760
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	448,677,757	442,379,980
Total Aktive Afatshkurtra		1,388,361,340	1,771,621,728
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	532,674,680	534,593,053
Aktive afatgjata jomateriale		-	602,000
Llogari të arkëtueshme afatgjata	11	136,970,781	30,312,787
Total aktive afatgjata		669,645,461	565,507,840
Total aktive		2,058,006,801	2,337,129,568
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	12	528,415,307	728,550,252
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	130,727,621	122,192,690
Detyrime tatimore	14	3,805,185	27,563,534
Të tjera detyrime	15	8,626,815	12,741,595
Total Detyrime afatshkurtra		671,574,928	891,048,071
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	16	164,537,090	138,166,000
Të ardhurat e shtyra	17	752,636,872	874,660,411
Llogari të pagueshme afatgjata	18	104,817,276	82,866,308
Total detyrime afatgjata		1,021,991,238	1,095,692,719
Totali i detyrimeve		1,693,566,166	1,986,740,790
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		135,300,000	135,300,000
Rezerva ligjore		11,946,854	11,301,684
Rezerva të tjera		203,048,005	190,858,695
Rezerva statutore		25,006	25,006
Fitimi i ushtrimit		14,120,770	12,903,393
Total kapitali	19	364,440,635	350,388,778
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		2,058,006,801	2,337,129,568

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Konsoliduar e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	812,000,626	602,226,264
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	3,673,823	3,492,919
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera		(670,696,768)	(485,212,199)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	22	(650,516,459)	(470,254,754)
2) Të tjera shpenzime	23	(20,180,309)	(14,957,445)
Shpenzime të personelit	24	(70,861,666)	(56,503,117)
1) Paga dhe shperblime		(61,323,967)	(49,167,826)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(9,537,699)	(7,335,291)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(46,273,225)	(34,449,509)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(154,062)	(690,997)
Shpenzime financiare	26	(10,146,423)	(13,480,059)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme		(10,358,550)	(13,338,203)
2) Shpenzime të tjera financiare		212,127	(141,856)
Fitimi/humbja para tatimit		17,542,305	15,383,302
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(3,421,535)	(2,479,909)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	27	(3,421,535)	(2,479,909)
2) Shpenzimi aktual i tatimit te shtyre		-	-
Fitimi/humbja e vitit		14,120,770	12,903,393
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		14,120,770	12,903,393

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albavia sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Konsoliduar e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva statutore dhe ligjore	Rezerva të tjera	Rezerva të rivlerësimit	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2015	135,300,000	10,816,389	181,165,018	(2,029)	10,206,007	337,485,385
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitimi / Humbja e vitit					12,903,393	12,903,393
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:						
Transferim në fitime të mbartura		510,301	9,695,706		(10,206,007)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	135,300,000	11,326,690	190,860,724	(2,029)	12,903,393	350,388,778
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						
Efektet e ndryshimit të kursit të këmbimit në konsolidim				(68,913)		(68,913)
Fitimi / Humbja e vitit					14,120,770	14,120,770
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:						
Transferim në fitime të mbartura		645,170	12,258,223		(12,903,393)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	135,300,000	11,971,860	203,118,947	(70,942)	14,120,770	364,440,635

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Albavia sh.p.k më 30/10/2017 dhe janë firmosur si më poshtë.


Shkëlqim Rakipaj
Administrator

Pasqyra e Konsoliduar e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	14,120,770	12,903,393
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	952,554	393,422
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	46,273,225	34,449,509
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	449,089	717,073
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	249,934,663	(629,737,498)
Rënie/(rritje) në inventarë	10,209,402	75,383,018
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(320,498,268)	622,615,595
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	1,441,435	116,724,512
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(44,326,941)	(35,331,559)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	125,000	269,000
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(44,201,941)	(35,062,559)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	26,371,090	(1,798,013)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	26,371,090	(1,798,013)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(16,389,416)	79,863,940
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	90,127,141	10,263,201
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit nga përkthimi	(68,913)	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 73,668,812	90,127,141

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Albavia Shpk është një shoqëri e regjistruar më 26 Mars 1998, me vendim gjykate Nr. 19077 datë 20 Mars 1998. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 7638 datë 19 Nëntor 1992 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 135,300,000 lekë.

Shoqëria ka NIPT J81527001Q. Selia e Shoqërisë është Rr. Sulejman Delvina, pranë Zayed Center, Ap.19, Tiranë.

Ortakët e Shoqërisë më 31.12.2016 janë:

Z. Genc Hafizi, qytetar shqiptar që zotëron 52 %

Z. Shkëlqim Rakipaj, qytetar shqiptar që zotëron 48%

Aktiviteti kryesor i kësaj Shoqërie është ndërtimi i rrugëve, ujësjellësa e kanalizime, ndërtime civile e industriale, prodhimi i materialeve asfaltike etj.

Në 31 dhjetor 2016 shoqëria ka 119 punonjës. (2015: 125)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
EUR/LEK	135.23	137.28
USD/ LEK	128.17	125.79

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Aktivitet afatgjata materiale (AAM) paraqiten në bilanc me vlerën e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë atë aktiv në vendin dhe kushtet ekzistuese. Normat e amortizimit të aplikuara janë sipas kërkesave fiskale dhe nuk marrin në konsideratë vlerësimin e amortizimit sipas jetës së dobishme të aktivit.

Për llogaritjen e amortizimit janë aplikuar këto norma amortizimi:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit në %		Metoda e llogaritjes
	2016	2015	
Toka	0%	0%	
Ndërtime e instalime	5/10%	5%	
Makineri e Paisje	10 %	5/10 %	Mbi vlerën e mbetur të AQT-ve
Mjete transporti	10 %	5/10 %	
Paisje zyre	20%	5%	
Paisje kompiuterike	25%	25%	
Instrumenta dhe vegla pune	20%	5%	

Për amortizimin e fabrikës së asfaltit janë përdorur norma amortizimi të diferencuara dhe konkretisht:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit në %		Metoda e llogaritjes
	2016	2015	
Impianti Teknologjik	5 %	5 %	Mbi vlerën e mbetur të AQT-ve
Pajisje energjitike e elektrike	5 %	5 %	
Pajisje të tjera teknike	5 %	5 %	

Llogaritja e amortizimit për AQT e hyra gjatë vitit bëhet duke filluar nga data një e muajit pasardhës.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	58,732,765	83,449,385
Vlera monetare në arkë	14,658,014	6,395,501
Total mjete monetare Albavia Shqipëri	73,390,779	89,844,886
Total mjete monetare Kosova	278,033	282,255
	73,668,812	90,127,141

(Vlerat janë në Lek)

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Klientë për punime në infrastrukturë rrugore	208,455,374	365,946,819
Klientë për shitje apartamentesh	59,363,420	31,351,232
Klientë për shitje produktesh	2,621,778	21,624,288
Klientë për të tjera	68,779,945	64,847,400
Klientë për garanci punimesh	47,035,300	133,201,409
	<u>386,255,817</u>	<u>616,971,148</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Albavia & Sintram (Kërkesa për arkëtim)	236,845,111	310,520,088
Albavia & Sintram (Të tjera kërkesa)	16,456,948	15,094,802
Emuliv	8,006,792	7,988,252
Karl Gega	172,046,756	217,582,237
Genc Hafizi	9,353,800	9,476,800
Shkëlqim Rakipaj	-	14,338,796
	<u>442,709,407</u>	<u>575,000,975</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Pjesa e detyrimeve dhe gjobave kompesuar por që janë në proces gjyqësor (Albavia Shqipëri)	2,908,307	2,908,307
TVSH për t'u rregulluar	111,155	-
Tatim në burim për t'u rregulluar (paguar në Kosovë)	217,499	217,499
Të tjera	35,698	35,698
Të tjera llogari të arkëtueshme	12,426,530	12,421,220
Total llogari të arkëtueshme të tjera Albavia	<u>15,699,189</u>	<u>15,582,724</u>
Total llogari të arkëtueshme të tjera Kosova	-	-
	<u>15,699,189</u>	<u>15,582,724</u>

(Vlerat janë në Lek)

8. Inventari

Inventari paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Stoku i materialeve të para	10,704,298	8,043,842
Stoku i materialeve ndihmëse	6,997,323	13,320,096
Stoku i produkteve të gatshme	-	674,590
Inventari i imët	3,648,737	6,715,291
Punime në process	-	2,805,941
	<u>21,350,358</u>	<u>31,559,760</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Leja e ndërtimit për ndërtimin e banesës	6,159,331	6,212,289
Parapagime Gener 2 për Qukësin	397,107,182	429,507,691
Parapagime për furnizim vendosje Albit	4,166,668	4,166,667
Sigurime objekti Inter Albania dhe Ansig	466,666	2,493,333
Të tjera shpenzime në avancë për projektin Qukes	40,777,910	-
	<u>448,677,757</u>	<u>442,379,980</u>

10. Aktive Afatgjata Materiale

<i>Kosto</i>	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 Janar 2015	18,119,542	236,301,473	462,541,213	153,288,162	26,126,270	896,376,660
Shtesa	-	-	12,759,280	17,399,029	5,173,250	35,331,559
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(2,045,833)	(12,305,550)	-	(14,351,383)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	18,119,542	236,301,473	473,254,660	158,381,641	31,299,520	917,356,836
Shtesa	-	-	42,672,144	560,930	1,093,867	44,326,941
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(37,830)	(1,001,087)	(9,000)	(1,047,917)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	18,119,542	236,301,473	515,888,974	157,941,484	32,384,387	960,635,860
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 1 Janar 2015	-	49,142,731	227,252,863	64,435,864	14,503,718	355,335,176
Amortizimi i vitit	-	11,815,073	15,179,441	4,658,530	2,796,465	34,449,509
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(1,439,546)	(5,581,356)	-	(7,020,902)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	60,957,804	240,992,758	63,513,038	17,300,183	382,763,783
Amortizimi i vitit	-	11,815,073	21,620,446	9,525,531	2,710,175	45,671,225
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(21,219)	(443,609)	(9,000)	(473,828)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	72,772,877	262,591,985	72,594,960	20,001,358	427,961,180
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	18,119,542	175,343,669	232,261,902	94,868,603	13,999,337	534,593,053
Gjendja më 31 dhjetor 2016	18,119,542	163,528,596	253,296,989	85,346,524	12,383,029	532,674,680

11. Llogari të arkëtueshme afatgjata

Llogari të arkëtueshme afatgjata më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve	45,804,257	-
Gener 2	6,149,891	-
TRISS-Ndërtim shpk	-	30,312,787
Karl Gega	17,279,968	-
Albavia & Sintram shoqëria e thjeshtë	67,736,665	-
	<u>136,970,781</u>	<u>30,312,787</u>

Këto kërkesa përfaqësojnë shumat e ndalura për garancitë e punimeve të kryera nga shoqëria në rrugët e Tiranës me investitor Bashkinë e Tiranës, Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, Komunën Paskuqan, Bashkinë Vorë, Bashkia Durrës, Fondi i Zhvillimit Shqiptar, Drejtoria Rajonale Rrugore Shkodër, etj .

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Furnitorë për punime të kryera	284,129,698	501,590,622
Furnitorë për materiale	207,490,896	183,131,278
Furnitorë për shërbime	17,336,399	16,886,659
Furnitorë për garanci të ndalura	18,986,632	26,462,835
	<u>527,943,625</u>	<u>728,071,394</u>
Furnitorë shërbime Kosovë	471,682	478,858
	<u>528,415,307</u>	<u>728,550,252</u>

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Emuliv shpk	40,645,440	40,929,190
Karl Gega konstruksion	90,082,181	81,263,500
	<u>130,727,621</u>	<u>122,192,690</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
TVSH për t'u paguar	1,211,175	25,293,890
Tatim mbi fitimin	952,554	161,769
Tatimi në burim	28,814	21,317
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,384,172	1,449,720
Tatim mbi të ardhurat e personale	228,470	636,838
	<u>3,805,185</u>	<u>27,563,534</u>

(Vlerat janë në Lek)

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime ndaj punonjësve	4,411,497	5,376,897
Të tjera	4,215,318	7,364,698
	<u>8,626,815</u>	<u>12,741,595</u>

16. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Raiffeisen Leasing (Tirana Leasing)	5,385,995	8,781,969
Tirana Bank Overdraft	159,151,095	129,384,031
	<u>164,537,090</u>	<u>138,166,000</u>

17. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Autoriteti Rrugor Shqiptar	-	17,151,448
Karl Gega Tirane	-	3,463,883
Albavia & Sintram shoq. e thjeshtë	752,636,872	854,045,080
	<u>752,636,872</u>	<u>874,660,411</u>

18. Llogari të pagueshme afatgjata

Llogaritë e pagueshme afatgjata më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Furnitorë për garanci të ndalura	48,926,367	25,878,534
Detyrime te tjera afatgjata	55,890,909	56,987,774
	<u>104,817,276</u>	<u>82,866,308</u>

Furnitorët për garanci të ndaluara lidhen me ndalesat e bëra nënkontraktorëve që janë në kontrata joint venture me Shoqërinë në objektet "Ndërtim Ujësjellësi Koplík", "Ndërtim Unaza Shkodër", "Ndërtim rruga Qukes-Qafe Plloce", "Ndërtim By Pass Plepa-Rrogozhinë Loti 7", "Ndërtim Ura e Pjegzës", "Rikonstruksion rruga Rruga Nacionale-Dajc", "Ndërtim Ura dhe Rruga Zllakuqan, Kosovë" etj.

Shoqëria ka marrë hua ndaj palëve të treta individë dhe ortakëve me qëllim të financimit të investimeve si edhe për mbulimin e nevojave për kapital punues. Për këto hua nuk janë llogaritur apo paguar interesa.

Albavia sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

19. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 është si mëposhtë:

	31 dhjetor 2016			31 dhjetor 2015		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Shkëlqim Rakipaj	792	64,944,000	48%	792	64,944,000	48%
Genc Hafizi	858	70,356,000	52%	858	70,356,000	52%
	1,650	135,300,000	100%	1,650	135,300,000	100%

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Kryerja e shërbimeve (Ndërtimi)	811,855,932	598,616,644
Nga shitja e prodhimit të vet (asfalte)	-	1,464,900
Nga shitja e mallrave	101,494	142,800
Të tjera shitje e shërbime (Makineritë)	43,200	2,001,920
	812,000,626	602,226,264

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	690,102,087
Shtohen të ardhurat e rimarra nga 2014	
Zbriten të ardhurat e shtyra për 2015	122,023,539
Zbritet vlera kontabël neto e AMM-ve të shitura përfshirë në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	(574,089)
Zbriten rivlerësimet e mallrave	
Shtohet efekti i kurseve të këmbimit të përfshira në zërin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"	4,122,912
Shtohen të ardhurat nga dogana në Janar 2015	
Shuma e qarkullimit të korrektuar	815,674,449
Sipas Kontabilitetit	815,674,449
Diferenca	-

(Vlerat janë në Lek)

21. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Fitim /(humbje) nga shitja e AAM-ve	(449,089)	(717,073)
Fitim /(humbje) nga kursi i këmbimit	4,122,912	4,209,992
	3,673,823	3,492,919
	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Fitim humbje nga shitja e asetëve		
Të ardhura nga shitja e AMM-ve	125,000	(269,000)
Vlera kontrabël e AMM-ve të shitura	(574,089)	986,073
	(449,089)	717,073
	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Diferenca këmbimi		
Humbje nga këmbimet valutore	(12,940,238)	(9,867,950)
Fitime nga këmbimet valutore	17,063,150	14,077,942
	4,122,912	4,209,992

22. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Kosto e materialeve të para	293,583,400	221,863,102
Kosto e shërbimeve të kryera	356,933,059	248,391,652
Nënkontraktorët	325,831,203	237,710,404
Riparime e mirëmbajtje	6,786,025	1,554,986
Shpenzime udhëtime dieta	2,741,600	195,862
Qira për prodhimin, magazinimin	600,000	1,000,000
Analiza laboratorit dhe studime gjeologjike (ITM)	18,694,231	3,310,400
Konsulencë inxhinierike	2,280,000	4,620,000
	650,516,459	470,254,754

Albavia sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Taksa vendore	743,576	415,473
Taksë regjistrimi për mjetet	1,112,664	670,608
Shpenzime telefoni, poste dhe internet	1,297,602	1,398,108
Shërbime bankare	1,783,566	1,801,225
Sigurime e Prime	2,173,312	1,774,374
Analiza, konsulencë dhe studime projektive	1,423,707	1,097,797
Shërbime të ndryshme nga të tretë	1,749,067	1,266,440
Pagesa administrative	545,045	496,378
Blerje energji, avull, ujë	805,494	606,598
Blerje kancelari	634,011	1,653,544
Shpenzime qeraje	1,244,770	1,620,826
Shpenzime për pritje e përfaqësime	333,442	141,900
Shpenzime të tjera	4,890,617	316,529
Transferime, udhëtime, dieta për administratën	1,443,436	1,697,645
	20,180,309	14,957,445
Shpenzime të tjera Kosova	-	-
	20,180,309	14,957,445

24. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Pagat e personelit	61,323,967	49,167,826
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	9,537,699	7,335,291
	70,861,666	56,503,117

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 119 (2015: 125).

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Gjoba dhe dëmshpërblime	154,062	690,997
	154,062	690,997

26. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të Shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime për interesa	10,358,550	13,429,119
Të ardhura nga interesat	-	(90,916)
Shpenzime financiare	27	610,038
Të ardhura financiare	(212,154)	(468,182)
	<u>10,146,423</u>	<u>13,480,059</u>

27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	17,542,305	15,383,302
Total shpenzime të panjohura	5,267,931	1,149,426
Shpenzime Pritje e Përcjellje	333,442	141,900
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	154,062	690,997
Shpenzime të tjera	4,780,427	316,529
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>22,810,236</u>	<u>16,532,728</u>
Humbje fiskale e mbartur	-	-
<i>Tatim fitimi @15%</i>	<u>3,421,535</u>	<u>2,479,909</u>

28. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Albavia & Sintram	321,038,724	-	347,914,230	-
Emuliv	8,006,792	40,645,440	7,988,252	40,929,190
Karl Gega	189,326,724	90,082,181	217,582,237	81,263,500
Genci Hafizi	9,353,800	-	9,476,800	-
	527,726,040	130,727,621	582,961,519	122,192,690

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Karl Gega	-	27,953,110	39,048,504	5,094,268
Emuliv	-	1,000,000	-	5,069,535
Albavia & Sintram	349,000,917	-	-	-
	349,000,917	28,953,110	39,048,504	10,163,803

Shpërblimin total të dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është 3,137,274 Lek.

	31 dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Administratori Shkëlqim Rakipaj	2,717,154	2,717,154
Administratori Genc Hafizi	420,120	420,120
	3,137,274	3,137,274

29. Pasivet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Referuar garancive të Shoqërisë me Bankën TIRANA sha listohen si më poshtë :

Garanci Kontratë dhe Ofertë:

11,690,000 ALL - Rikonstruksion i Rrugëve Bashkia Lezhe me përfitues FSHZH lëshuar në datë 25.05.2016 me afat përfundimin e garancise se punimeve.

340,000 EUR – Kontratat te financuara nga Banka Boterore per Mirembajtjen e Rrugeve me përfitues ARRSH lëshuar në datë 06.10.2016 me afat përfundimin e prokurimit.

Referuar garancive të Shoqërisë me Bankën CREDINS sha listohen si më poshtë :

Garanci Kontrate dhe Oferte:

28,936,153 ALL - Rikonstruksion i Rrugëve Bashkia Lezhe me përfitues FSHZH lëshuar në datë 31.08.2016 me afat përfundimin e garancise se punimeve.

340,000 EUR – Kontratat te financuara nga Banka Boterore per Mirembajtjen e Rrugeve me përfitues ARRSH lëshuar në datë 06.10.2016 me afat përfundimin e prokurimit. Kjo BG eshte lëshuar nga banka Credins me fondet e veta te shoqerise.

30. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.